

## **RELACION**

**PËR**

### **PROJEKTVENDIMIN**

**PËR**

#### **MIRATIMIN E DOKUMENTIT UDHEZUES TË POLITIKAVE MBI ZONATE PËRCAKTUARA PËR AKUAKULTURË (ZPA) NË SHQIPËRI**

#### **I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN**

Qëllimi i hartimit të këtij projektvendimi është miratimi i dokumentit udhëzues të politikave mbi Zonat e Përcaktuara për Akuakulturë (ZPA) në Shqipëri, kjo bazuar edhe në pikën 2, të nenit 5, të Ligjit Nr. 103/2016 “Për akuakulturën”, i ndryshuar, sipas të cilit se Zonat e Përcaktuara për Akuakulturë miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Ky dokument udhëzues i politikave propozon krijimin e ZPA-ve bazuar në njojuritë më të mira shkencore dhe social-ekonomike të disponueshme, të siguruara nga institucionet përgjegjëse kombëtare.

ZPA-të janë zona të përcaktuara gjeografikisht, të kufizuara nga një poligon, në të cilat lejohen ose kufizohen të gjitha ose disa aktivitete të akuakulturës për të nxitur zhvillimin e akuakulturës në një zonë specifike. ZPA-ja përfshin zona të veçanta, të caktuara, me qëllim aktivitetin e akuakulturës, së bashku me infrastrukturën në shërbim të saj.

Krijimi i ZPA-ve do të sigurojë një integrim më të mirë të akuakulturës në zonat bregdetare dhe është një parakusht për dhënen e lejeve dhe qirave të reja përakuakulturë. Këto të fundit janë thelbësore për të pasur një kornizë rregullatore dhe administrative kushtuar akuakulturës dhe për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm të sektorit.

Me miratimin e këtij projektvendimi, Vendimi Nr. 113, datë 17.2.2021 "Për miratimin e dokumentit udhëzues të politikave mbi Zonat e Përcaktuara për Akuakulturë (ZPA) në Shqipëri", i ndryshuar, i Këshillit të Ministrave do të shfuqizohet sepse ky vendim miraton vetëm një zonë të përcaktuar të akuakulturës, zonën e Sarandës.

Ndërkohë me këtë projektvendim synohen të përcaktohen të gjitha zonat e përcaktuara për akuakulturë në Shqipëri, nismë e cila filloj që në vitin 2020 por për shkak të evidentimit nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit se zonat e përcaktuara të akuakulturës kishin mbivendosje me zonat e mbrojtura, u vendos miratimi vetëm për zonën e Sarandës. Tashmë pas dakordësimit paraprak me MTM-në janë ripërcaktuar zonat e akuakulturës detare.

## **IL VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE**

Projektvendimi i propozuar nuk është parashikuar në Planin Analistik të Projektakteve të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për vitin 2023.

Lidhur me kushtëzimet për shkak të zgjedhjeve vendore, sraqojmë se miratimi i tij nuk hyn tek ndalimet e parashikuara në nenin 91 dhe 92, të Ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2002 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, dhe Vendimit Nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregulator "Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve". Projektvendimi nuk krijon përfitime për individë ose subjekte private të cilat passjellen ndikime në zgjedhje.

## **III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTETE PRITSHME**

Akuakultura, në të gjithë botën, konsiderohet si një nga sektorët me rritjen më të shpejtë të prodhimit të ushqimit, duke kontribuar në sigurinë ushqimore, punësimin dhe zhvillimin ekonomik, dhe kjo prirje globale parashikohet të vazhdojë edhe në të ardhmen. Sipas statistikave të FAO-s, në vitin 2018 prodhimi total i akuakulturës botërore arriti në 82.1 milionë ton gjallesa ujore,

---

Relacion shpjegues për Projektvendimin e Këshillit të Ministrave "Për miratimin e dokumentit udhëzues të politikave mbi Zonat e Përcaktuara për Akuakulturë (ZPA) në Shqipëri".

me një vlerë totale të shitjes tek “porta e aktivitetit = te prodhuesi” prej 250.1 miliardë dollarësh (FAO, 2020). Në kushtet e ndryshimeve klimaterike, akuakultura do të luajë një rol gjithnjë e më të madh në sigurimin e proteinave me bazë shtazore. Sot për të prodhuar një kg mish nevojiten rrëth 15 000 litra ujë ndërsa për të prodhuar një kg peshk rrëth 3.5 litra ujë, pjesa më e madhe e të cilit është e riciklueshme.

Akuakultura në Shqipëri, si kudo në botë, përfaqëson një sektor të rëndësishëm dhe zoteron një potencial të madh për komunitetet bregdetare. Për më tepër, ajo mund të sigurojë përfitime të shumta për sa i përket të ushqyerit të mirë, dhe të sjellë rezultate pozitive social-ekonomike. Prodhimi i përgjithshëm nga uji i ëmbël, uji i njelmët dhe mjedisi detar, është rritur në mënyrë të qëndrueshme gjatë viteve të fundit nga 3,450 ton në vitin 2012 në 8907.7 ton në vitin 2022 dhe ka një vlerë rrëth 40 milionë € dhe rrëth 43% të prodhimit total të peshkimit. Eksportet e prodhimeve të akuakulturës për vitin 2022 ishin 12.6 milionë €.

Shqipëria ka çelur negociatat me Bashkimin Evropian dhe si e tillë, është në procesin e integrimit të legjislacionit të BE-së (*acquis*) në legjislacionin kombëtar. Përparimi në procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian varet nga arritjet që duhet të ketë Shqipëria në fushat kryesore. Qasja e BE-së kundrejt PZA është në kuadër të maritime-spatial-planning. Raporti i Progresit 2022 përshkruan: Qeveria miratoi planin e parë të zonave të përcaktuara për akuakulturën (PZA) në qarkun e Sarandës. Qeveria duhet të miratojë plane të tilla edhe për PZA-të e mbeturat të Shëngjinit, Durrësit dhe Vlorës. Kanë filluar përpjekjet për përgatitjen e PZA-ve për ujërat e brendshme. Detyrat e lëna në progres raport, në rast se nuk adresohen përcaktohen nga BE si *benchmark* që janë kushte që duhet të plotësohen për çeljen e kapitullit.

Në këtë kontekst, Ligji i ri Nr. 103/2016 “Për Akuakulturën është përafruar pjesërisht me disa Rregullore të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, mbi: Politikën e Përbashkët të Peshkimit; vendosjen e një kuadri të Komunitetit përmbledhjen, menaxhimin dhe përdorimin e të dhënave në sektorin e peshkimit dhe mbështetjen për këshillimin shkencor në lidhje me Politikën e Përbashkët të Peshkimit dhe Fondin Evropian Detar dhe të Peshkimit.

Sa i takon zhvillimit të mëtejshëm të akuakulturës detare, pas miratimit të Ligjit për Akuakulturën në vitin 2016, procesi i autorizimit (licensimit dhe dhënies me qira) të aktiviteteve të reja të akuakulturës do të lejohet vetëm kur plani përmiratimin e Zonave të Përcaktuara për Akuakulturë (ZPA) është përgatitur dhe

---

Relacion shpjegues për Projektvendimin e Këshillit të Ministrave “Për miratimin e dokumentit udhëzues të politikave mbi Zonat e Përcaktuara për Akuakulturë (ZPA) në Shqipëri”.

aprovar (KE, 2018; KE, 2019). Sa i takon marrëveshjeve ndërkombëtare, Shqipëria është një palë kontraktuese e Komisionit të Përgjithshëm të Peshkimit për Mesdheun (GFCM) të FAO-s dhe po zbaton rekomandimet e tij. Konkretisht për akuakulturën, në vitin 2017 GFCM ka miratuar “Strategjinë për zhvillimin e qëndrueshëm të Akuakulturës në Mesdhe dhe Detin e Zi (Rezoluta GFCM/41/2017/1)” e cila përcakton kornizën rajonale për zhvillimin e aktiviteteve të harmonizuara të akuakulturës dhe planeve të veprimit në rajon me synimin për të ndjekur zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit.

Strategjia e GFCM vë theks të fortë në përmirësimin e drejtimit të akuakulturës dhe avokon për planifikimin e koordinuar hapësinor detar dhe zgjedhjen e zonave të përshtatshme për akuakulturë përmes krijimit të ZPA-ve. Strategjia e GFCM është paraprirë nga Rezoluta GFCM/36/2012/1 mbi udhëzimet për Zonat e Përcaktuara për Akuakulturë (ZPA), e cila (Rezoluta) mbështet parimet e mirëqeverisjes (FAO, 2012).

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2030 përcakton: Shqipëria është e pozicionuar mirë për të zhvilluar një akuakulturë “blu” që mbështetet në adoptimin e praktikave të përgjegjshme të kultivimit, bazuar në certifikimin dhe mekanizmat e tjera të marketingut të sektorit privat. Sektori publik mund të lehtësojë investimet e sektorit privat përmes planifikimit dhe administrimit, mbështetjes financiare dhe mekanizmave të tjera. Ndërtimi i një marke kombëtare për akuakulturën “blu” në Shqipëri është e nevojshme që produktet e akuakulturës të prodhua në vend të konkurojnë në tregjet e huaja. Ligji Nr. 103/2016 “Për Akuakulturën”, i ndryshuar, në bazë të të cilit synohet të miratohet ky vendim, ka për qëllim të kontribuojë në nxitjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të industrisë së akuakulturës, nëpërmjet rritjes së konkurrueshmërisë. Ligji përcakton bazën e nevojshme ligjore për ushtrimin e veprimtarisë ekonomike të prodhimit dhe kultivimit të organizmave ujorë në fushën e akuakulturës në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Krijimi i ZPA-ve do të sigurojë një integrim më të mirë të akuakulturës në zonat bregdetare dhe është një parakusht për dhënen e të drejtës së zhvillimit të akuakulturës dhe qirave të reja për akuakulturë. Këto të fundit janë thelbësore për të pasur një kornizë rregullatore dhe administrative kushtuar akuakulturës për të sigruar një zhvillim të shëndoshë dhe të qëndrueshëm të sektorit.

Të dhënat e përdorura për ZPA-të janë me vlerë jo vetëm për përdoruesit që lidhen direkt me akuakulturën, por për të gjithë përdoruesit publikë detarë dhe tokësorë.

Aktualisht, sektori i akuakulturës në Shqipëri gjeneron rreth 600 vende pune të drejtpërdrejta, duke përfshirë punën me kohë të plotë dhe të pjesshme, si dhe të gjitha punësimet indirekte në aktivitetet ndihmëse ekonomike përgjatë zinxhirit të vlerës (p.sh. përpunimi, shpërndarja, shitja me pakicë, paketimi, pajisjet, industria e ushqimit, shërbimi ushqimor, turizmi, etj.). Shqipëria ka një potential të madh për të zhvilluar më tej sektorin duke pasur parasysh disponueshmërinë e zonave bregdetare në të cilat mund të zhvillohen aktivitetet e akuakulturës në ZPA-të për prodhimin e peshqve dhe të molusqeve.

Një zgjerim i sektorit të akuakulturës do të gjeneronte punësim të mëtejshëm direkt dhe indirekt në të gjithë zinxhirin e vlerës, ndërsa në të njëjtën kohë do të kontribuonte në rritjen e marrjes së proteinave nga produktet e shëndetshme të peshkimit.

Për qëllimet e këtij dokumenti udhëzues të politikave, ZPA-të janë marrë në konsideratë për ato aktivitete të akuakulturës, të cilat lejohen sipas Ligjit Nr. 103/2016 “Për Akuakulturën”, i ndryshuar, dhe janë përcaktuar si më poshtë:

- Kategoria 01 e ZPA-ve – peshqit
- Kategoria 02 e ZPA-ve – molusqet

Për më tej, janë dhënë rekomandime për: (i) ndjekjen e zhvillimit të akuakulturës në ZPA përmes një sistemi monitorimi të bazuar tek treguesit; (ii) krijimin e sistemeve të monitorimit mjedisor për të siguruar qëndrueshmërinë mjedisore.

Gjithashtu, është dhënë edhe një përshkrim gjithëpërfshirës i metodologjisë për të identifikuar ZPA-të si dhe janë paraqitur referencat e përdorura.

#### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Projektvendimi është në përputhje me Kushtetutën, Ligjin Nr. 103, datë 20.10.2016, “Për akuakulturën”, i ndryshuar dhe me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 460, datë 29.6.2022 “Për miratimin e Strategjisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Peshkimit, 2021-2027” dhe Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrin Evropian 2030.

Dokumenti Udhëzues i Politikave për ZPA-të është në përputhje me:

- Rezolutën GFCM/36/2012/1 miratuar në vitin 2012, e cila jep udhëzime për zbatimin e ZPA-ve dhe krijon kornizën themelore për të orientuar shtetet drejt miratimit të tyre (FAO, 2012).
- Udhëzuesin Teknik të GFCM mbi përcaktimin e ZPA-ve (Macias et al., 2019).
- Rezolutën GFCM/41/2017/2 mbi udhëzimet për modernizimin e proceseve të autorizimeve dhe qiradhënieve për aktivitetet e akuakulturës (FAO, 2018).
- Një udhëzues për krijimin e zonave bregdetare kushtuar akuakulturës në Mesdhe dhe Detin e Zi, të BE-së (<https://maritime-spatial-planning.ec.europa.eu/practices/allocated-zones-aquaculture-guide-establishment-coastal-zones-dedicated-aquaculture>)

## **V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)**

Ky projektvendim nuk ka për qëllim përafrimin e legjislacionit me *Acquis Communautaire* në mënyrë specifike, por miratimi i tij sipas metodologjisë së FAO-GFCM dhe BE-së është kërkesë e KE-së. Ndërsa Ligji Nr. 103/2016 “Për akuakulturën”, i ndryshuar, nga i cili rrjedh detyrimi mbi këtë projektvendim është përafruar pjesërisht me disa rregullore të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, mbi: Politikën e Përbashkët të Peshkimit; vendosjen e një kuadri të Komunitetit për mbledhjen, menaxhimin dhe përdorimin e të dhënave në sektorin e peshkimit dhe mbështetjen për këshillimin shkencor në lidhje me Politikën e Përbashkët të Peshkimit; dhe Fondin Evropian Detar dhe të Peshkimit.

## **VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT**

Projektvendimi ka përmbajtjen si më poshtë vijon:

*Në pikën 1* të projektvendimit propozohet miratimi i dokumentit udhëzues të politikave mbi Zonat e Përcaktuara për Akuakulturë (ZPA) në Shqipëri, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ndërsa Dokumenti Udhëzues i Politikave në hyrje përmban një përmbledhje ekzekutive të këtij studimi, përshkruan akuakulturën në një vështrim në nivel global dhe rajonal, përcakton zonat e akuakulturës në Shqipëri, masat dhe identifikimin e Zonave të Përcaktuara për Akuakulturë përgjatë bregdetit shqiptar.

---

<sup>6</sup> Relacion shpjegues për Projektvendimin e Këshillit të Ministrave “Për miratimin e dokumentit udhëzues të politikave mbi Zonat e Përcaktuara për Akuakulturë (ZPA) në Shqipëri”.

Dokumenti është strukturuar në dy seksione: seksioni i parë paraqet rezultatet kryesore me hartat e ZPA-ve përgjatë bregdetit shqiptar, ndërsa seksioni i dytë përshkruan metodologjinë e aplikuar si dhe informacionin tjetër thelbësor mbi të cilin është bazuar përzgjedhja e ZPA-ve.

*Në pikën 2 parashikohet që Vendimi Nr. 113, datë 17.2.2021 “Për miratimin e dokumentit udhëzues të politikave mbi Zonat e Përcaktuara për Akuakulturë (ZPA) në Shqipëri”, i ndryshuar, i Këshillit të Ministrave shfuqizohet.*

*Në pikën 3 parashikohet se për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe ministritë e tjera të linjës.*

## **VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT**

Institucionet kryesore që ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi janë Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe ministritë e tjera të linjës që preken nga ky projektakt.

## **VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT**

Ky projektvendim është hartuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Ndërsa dokumenti udhëzues është hartuar nga Fondacioni i Akademisë Italiane të Marinës Tregtare në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në kuadër të projektit “Mbështetje për sektorin e peshkimit në Shqipëri” (EuropeAid/155184/Act/AL) dhe posaçërisht nën Aktivitetin 1.10 - “Hartimi i planit mbi Zonat e Përcaktuara për Akuakulturë (ZPA) bazuar në udhëzimet dhe metodologjite përkatëse”. Aktivitetet u ndërmorën brenda kuadrit të bashkëpunimit me Komisionin e Përgjithshëm të Peshkimit për Mesdheun (GFCM), dhe në bashkëpunim me Ministrinë Italiane të Politikave të Bujqësisë, Ushqimit dhe Pylltarisë (MIPAAF).

Dokumenti udhëzues është konsultuar paraprakisht me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit ku janë reflektuar sugjerimet për ndryshimin e disa koordinatave të ZPA-ve me qëllim shmangien e mbivendosjes së tyre me zonat e mbrojtura.

## **IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Ky projektvendim nuk shoqërohet me efekte financiare shtesë për buxhetin e shtetit por zbatimi i tij sjell të ardhura të pritshme.

